



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.01, datë.24.04.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TË AKADEMISË SË FUTBOLLIT DURRËS, ME
AMBJENTE SPORTIVE DHE NË FUNKSION TË FONDACIONIT “DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY”, ME 1, 2 DHE 3 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË”
ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SPITALLËS, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues Fondacionin “Dyrrah City Football Academy”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës, me ambjente sportive dhe në funksion të Fondacionit “Dyrrah City Football Academy”, me 1, 2 dhe 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në zonën e Spitalllës, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues Fondacionin “Dyrrah City Football Academy”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31 / 10 / 2024